



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KONTRATË PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

E lidhur në mesë të dy palëve si më poshtë:

1. Komunës në Rahovec të cilën e përfaqëson, z. **Smajl Latifi**, Kryetari i Komunës në Rahovec (në tekstin e mëtejshëm mbështetës financiar) dhe
2. OJQ-së **“SHKOLLA E FUTBOLLIT DRENOCI”** person i autorizuar z. Asllan Kastrati nga Drenoci, Certifikata me numri Fiskal 601745378 dhe me numër të regjistrimit të biznesit 5116513-6, në (tekstin e mëtejshëm, përfutues i mjeteve financiare).

EMRI I PROJEKTIT: MBËSHTETJE NË FUSHËN E SPORTIT

KUSHTET E KONTRATËS

Neni 1.

Emri i projektit/programit: MBËSHTETJE NË FUSHËN E SPORTIT-2018

Referenca/ numri i kontratës 12/2018.

Vlera e kontratës në euro: 500€ (Pesëqind euro)

Periudha e zbatimit të projektit nga data 01.03.2018 deri 31.12. 2018

Linja buxhetore, nga kodi i Subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 2.

Mjetet nga neni 1 i kësaj kontratë mund të përdoren vetëm për zbatimin e projektit, në përputhje me kushtet e thirrjes publike dhe formës përshkruese të projektit dhe formularit të buxhetit të projektit, të cilat konsiderohen pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Neni 3.

Mjetet nga neni 1 i kësaj kontrate do të paguhën në llogarinë bankare: Nr. Llogarisë bankare 1931995124031173 në Bankën Kombëtare Tregtare BKT .

Neni 4.

1. Për të kontrolluar përdorimin e duhur të burimeve, përfutuesi është i obliguar t'i dorëzojë raport me shkrim ofruesit të mbështetjes financiare për zbatimin e projektit i cili duhet të përfshijë:
 - 1.1 Raportin narrativ (të cilin e dorëzon në formë të shtypur, përmes postës, dhe/ ose në formë elektronike me e-mail apo me post në një CD, DVD ose USB-në, apo në një formë tjetër sipas kërkesës)i cili duhet të dorëzohet në formë të shkruar (shtypur) dhe përmes postës elektronike në adresë të zyrtarit kompetent.

1.2 Raporti financiar i cili dorëzohet nga përfituesi në formë të shkruar dhe postës elektronike duhet të jetë i kompletuar me dokumentacion të detajuar përfshirë të gjithë koston financiare dhe anekset:

- a) Për pagesat e kryera me transaksion bankar: kopjet e faturave, emrin e përfituesit dhe llogarinë bankare përkatëse;
- b) Për pagesat në para të gatshme: kopjet e faturave emrin e përfituesit, kopje të dëftesës së pagesës nga arka, raportet e parasë së gatshme.
- c) Dokumentët tjerë: të ndërlidhur me udhëtimin, agjendat dhe të ngjashme, i bashkëngjitni dosjet shoqëruese, dokumentet mbi të cilat pagesat janë kryer si (kontrata, marrëveshjet etj.) dhe të ngjashme.

2. Anekset të tjera lidhur me zbatimin e projektit, dëshmi të implementimit të aktiviteteve të projektit përfshirë (listën e pjesëmarrësve, fletë vlerësimit, fotografi nga ngjarja, kopje të botimeve, etj.)
3. Përfituesi duhet të dorëzojë raport tremujor/gjysmë-vjetor/raport vjetor/ përfundimtar për zbatimin në afat prej: 15 ditë pas skadimit të periudhës së raportimit, raportet duhet të dorëzohen te financuesi sipas formularëve të paraparë.

Neni 5.

1. Ofruesi i mbështetjes financiare rezervon të drejtën për monitorimin dhe vlerësimin e ekzekutimit të projektit, duke përfshirë shqyrtimin financiar dhe shpenzimeve të vazhdueshme në çdo kohë gjatë implementimit të projektit dhe për një periudhë prej 1 vit pas përfundimit të projektit.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare mund të bëjë drejtpërdrejtë kontrollin e mësipërm të kësaj kontrate përmes një vizite studimore në ambientet e përfituesit por në rast të kontrollit të tillë, përfituesi do të njoftohet të paktën 7 ditë përpara kontrollit nga ofruesi i mbështetjes financiare.

Neni 6.

Ofruesi i mbështetjes financiare ka të drejtë që për qellim të mbikëqyrjes së përdorimit të fondeve sipas nenit 1 të kësaj kontrate të kontaktoj direkt të gjithë personat juridik dhe fizik të cilët janë paguar nga fondet e projektit, sipas dokumenteve të raportuara nga përfituesi i mbështetjes financiare publike.

Neni 7.

1. Përfituesi merr përsipër të njoftoj me kohë ofruesin e mbështetjes financiare për ndryshimet e vogla dhe të mëdha në kontratë.
 - 1.1 Ndryshimet e vogla në kontratë që nuk kërkojnë ndryshimin e kontratës përmes shtojcave mund të jenë:
 - a) Ndryshime në buxhet në mes të kapitujve të buxhetit më pak se 10 %
 - b) Ndërrimi i një anëtarit të ekipit të projektit
 - c) Ndryshimi i llogarisë bankare të anëtarëve të projektit
 - d) Ndryshimi i adresës ose të dhënave të tjera të projektit
 - e) Ndryshime të vogla në projektet që nuk ndikojnë në qëllimin dhe objektivat (psh. ndryshime të vogla në kohën e aktiviteteve)
 - 1.2 Ndryshimet më të mëdha të kontratës kërkojnë ndryshimin e kontratës përmes një shtojce dhe nënshkrimin e saj nga ofruesi i mbështetjes financiare dhe përfituesi. Ndryshimet më të mëdha në kontratë mund të jenë:
 - a) Ndryshimet në buxhet në mes të kapitujve të buxhetit prej më shumë se 10%
 - b) Zgjatjen e kohës së implementimit të projektit (maksimumi 6 muaj)
 - c) Shtimi i aktiviteteve të reja në kuadër të projektit

- d) Ndryshimi i aktiviteteve që në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në qëllimin dhe objektivat e projektit
2. Ofruesi i mbështetjes financiare vendos në çdo rast nëse do të pranoj ndryshimin e kontratës ose jo dhe nëse ndryshimi përbën ndryshim të vogël ose të madh të kontratës

Neni 8.

1. Përfituesi mund të kërkoj ndryshimet në kontratë të paktën **30** ditë përpara përfundimit të projektit. Çdo ndryshim në kontratë duhet të kërkohet dhe të miratohet me shkrim. Kontrata nuk mund të ndryshohet ose të plotësohet nëse qëllimi apo efekti i ndryshimit e cenon konkurrencën apo trajtimin e barabartë sipas thirrjes publike.
2. Përfituesi nuk mund të kërkoj ndryshimin e dispozitave të kontratës pas përfundimit të periudhës së implementimit të projektit, siç është paraparë në nenin 1 të kësaj kontrate.
3. Ofruesi i mbështetjes financiare publike ka të drejtë të mos e miratojë dhënien e një pjese të fondeve dhe zgjatjen e periudhës së zbatimit të projektit nëse kjo ndryshon përmbajtjen dhe natyrën e projektit, ose në qoftë se kërkesa nuk ka bazë dhe arsye objektive për ndryshim të kontratës ose zgjatje të periudhës së zbatimit të projektit.
4. Vendimi për miratimin ose mosmiratimin e kërkesës për ndryshim të kontratës apo zgjatje të periudhës së zbatimit të projektit duhet të merret brenda **30** ditësh nga data e kërkesës së përfituesit

Neni 9.

Nëse ofruesi i mbështetjes financiare përcakton se përfituesi nuk është duke përdorur në mënyrë të papërshtatshme fondet e mbështetjes financiare për implementimin e projektit sipas kushteve të nenit **1** dhe **2** të kësaj kontrate, ose ka dështuar të zbatoj projektin brenda afatit të kontraktuar, në qoftë se nuk ka paraqitur raportet e duhura në kohë dhe me përmbajtjen e përcaktuar në nenin 4 të kontratës, ose nuk i ka lejuar ofruesit të mbështetjes financiare mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve sipas nenit **5** dhe **6** të kontratës, pagesat e mëtejshme do të pezullohen, dhe përfituesi është i detyruar të kthej mjetet e shpenzuara në mënyrë të papërshtatshme dhe mjetet ende të pashpenzuara, brenda **30** ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim për kthimin e mjeteve nga ofruesi i mbështetjes financiare.

Neni 10.

Nëse ofruesi i mbështetjes financiare përcakton se përfituesi nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale, do të mohohet e drejta për të përfutur mbështetje financiare në dy vitet e ardhshme.

Neni 11.

1. Përfituesi pranon që në të gjitha materialet e shtypura, video dhe materiale të tjera që lidhen me projektin të vendos logon dhe cimin e ofruesit të mbështetjes financiare si një institucion që financoj projektin i cili është objekt i kontratës.
2. Përfituesi pajtohet që t'i dorëzoj ofruesit të mbështetjes financiare për përdorim dhe publikim fotot, video dhe të dhëna audio të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, për të promovuar thirrjen publike dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë civile në Republikën e Kosovës.

Neni 12.

Ofruesi i mbështetjes financiare nuk është përgjegjës, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, për dëmet e që rrjedhin nga çdo veprimtari e përfituesit në zbatimin e projektit.

Neni 13.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate përfituesi pajtohet që si përfitues i burimeve publike të financimit për projektet me interes dhe në të mirën e publikut, nuk do të marrin pjesë në promovimin e ndonjë

interesi privat, politik, apo mbështetje për ndonjë parti politike apo kandidat të pavarur gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

Neni 14.

Në rast se paraqiten mosmarrëveshje në zbatimin e kësaj kontrate në mes të palëve kontraktuese dhe nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim dhe diskutime të ndërsjella, kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë Gjykata Themelore në Gjakovë.

Neni 15.

Për çështjet që nuk janë rregulluar me këtë kontratë, do të vlejné dispozitat e Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të dhe manuali për zbatimin e saj.

Neni 16.

Informacionet që përmban forma e përshkrimit të projektit dhe forma e buxhetit të projektit të cilën përfituesi e ka dorëzuar me rastin e aplikimit sipas thirrjes publike janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Neni 17.

Për çdo formë të komunikimit apo dorëzimit të njoftimit për ndryshime në kontratë dhe dorëzimin e raporteve lidhur me këtë kontratë, palët duhet të specifikojnë numrin e referencës së kontratës dhe emrin e projektit dhe të dërgojnë në adresën e mëposhtme.

1. Ardian Rama, Ardian.Ramal@rks-gov.net (për ofruesin e mbështetjes financiare)
2. Asllan Kastrati, kastratiasllan@gmail.com (për përfituesin e mbështetjes financiare)

Neni 18

Kjo kontratë e nënshkruar nga palët kontraktuese hartohet në 3, (tre) ekzemplar origjinal, ku 1, (një) e marrin përfituesi, ndërsa të tjerët mbesin për nevoja e mbështetësit financiar publik.


Neni 19.

Kontrata hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të palëve kontraktuese.


Përmes kësaj kontrate unë i pranoj kushtet e kësaj kontrate dhe solemnisht deklaroj dhe premtoj se do të realizoj me besnikëri, në mënyrë të hapur me ndërgjegje dhe për interes publik mbështetjen financiare nga ofruesi i mbështetjes financiare.

PALET KONTRAKTUESE

Përfituesi i mbështetjes financiare


Përfaqësuesi i autorizuar
Asllan Kastrati

Ofruesi i mbështetjes financiare:


Kryetari i Komunës
Smajl Latifi

